

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME DY ORTAK
"AUTO-TRANSPORT PUKA" SHPK

Sot me daten 17/01/2022 (dymijë e njëzet e dy), ne ortakët themelues :

- **Z.Shpetim Pemaj** i biri i Nezir , shtetas shqiptar , i datëlindjes 31 Korrik 1986, lindur në Qerret, Puke dhe banues në Durrës person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Leternjoftimi/karte I60731087D.
- **Z.Klinton Vila** i biri i Alfred, shtetas shqiptar , i datëlindjes 22 Korrik 1983, lindur në Puke dhe banues në Durrës person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Leternjoftimi/karte J30722098R.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Pergjegjësi të Kufizuar me dy ortak* " AUTO-TRANSPORT PUKA" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " AUTO-TRANSPORT PUKA" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, "Lagjja nr 15 , Rruga Aleksander Goga ,Zona kadastrale 8517, Truall me nr pasurie 153/415,Durrës".

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e:

- Transport mallrash brenda dhe jashte vendit. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit. Tregti automjetesh, brenda dhe jashte vendit,import-eksport.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë " **AUTO-TRANSPORT PUKA**" është 100.000 (njëqind mijë) lekë.



Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

1. Shpetim Pemaj zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.

2. Klinton Vila zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.

NENI 5

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Shpetim Pemaj**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9

LIKUJDIMI



Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES I SHOQËRISË
" AUTO-TRANSPORT PUKA" SH.P.K

Shpetim Pemaj

SHPETIM PEMAJ



Klinton Vila

Klinton Vila

